



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:107930

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06892266

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr.581/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Selman Salihu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale kundër të pandehurit B. R. nga fsh.Ll. K.L., të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4982/2022 të datës 18.12.2023, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje me të miturin E.P Vjedhje e rëndë nga 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 19.02.2025, në prani të prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të pandehurit dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare të të pandehurit av. Fidan Ibrahim si dhe të dëmtuarit, me dt.24.02.2025 publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**B. R.**, nga i ati I., i lindur me ... në P., me banim në fshatin Ll., me numër personal të letërnjoftimit ...,beqar, i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Më datë,18.09.2022 në ora 11:00 h në fshatin Ll., në Komunën e L. në rrugën "S. R.", i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasuror në mënyrë të kundërligjshme për veti apo për personin tjetër, në bashkëkryerje me të miturin E.P., kanë kaluar murin e kanë depërtuar në oborrin e shtëpisë të dëmtuarit R. R., e nga ty të pandehurit kanë vjedhur veturën e tipit '...' - ngjyrë e kaltër, metalike, me targa ....e cila kishte qenë e parkuar brenda oborrit, nën mbulojën e dyerve të oborrit, dhe së bashku me veturën ishin marr edhe mjete dhe vegla të punës të cilat ishin gjendur në bagazhin e veturës me ç' rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,

***-Me këtë i pandehuri B. R., në bashkëkryerje me të miturin E.P. kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.***

Andaj gjykata, konform të dispozitave të të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 71, nenit 315 par.1 nënpar.3.1 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

## DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 4 viteve nuk do të kryej asnjë veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30-€, si dhe shumën prej 20-€ në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimin, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari: R. R. nga fsh.Ll. K.L. udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.4982/2022 të datës 18.12.2023 ka akuzuar të pandehurin B.R. nga fsh.Ll. K.L., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje me të miturin E.P Vjedhje e rendë nga 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka deklaruar se e ndien veten fajtor, dhe e ka pranuar fajësinë, pa presion, në konsultim me mbrojtësin e tij. Ka shtuar se është hera e parë që i ka ndodhur një gjë e tillë dhe ka kërkuar falje ndaj të dëmtuarit. Veturën e ka kthyer tek i dëmtuari. Gjykatës i ka premtuar që nuk do ta persersë një veprim të tillë kurrë.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë të të mbrojturit të tij pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, andaj i gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë ta aprovoj dhe me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit të marrë parasysh rrethanat lehtësuese në vijim se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës dhe pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, se i pandehuri ka rënë ndesh për herë të parë me ligjin, i pandehuri ka shpreh keqardhje për kryerjen e veprës penale, i pandehuri ka premtuar se nuk do përsëris vepra penale, si dhe fakti se menjëherë pas kryerjes së veprës penale është kthyer objekti i veprës penale vetura Golf II. Gjykatës i ka propozuar që të pandehurit ne pajtim me ligjin të i caktoj një dënim më të butë.

Prokuroria e shtetit në seancën për shqyrtim fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ku pranimi i fajësisë ka mbështetje nga provat materiale me pamje nga vendi i ngjarjes, deklarimi i të pandehurit në polici me dt.08.11.2022. Tutje ka shtuar se ky pranimi fajësisë nuk ka pengesa ligjore që të pranohet si i tillë.

I dëmtuari në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se i bashkangjitet ndjekjes penale, ka kërkuar dëmshpërblim pra kërkesën pasurore juridike.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, pranimi i fajësisë është bërë në konsultim me mbrojtësin e tij dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, konform nenit 242 të KPPRK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke analizuar provat mbi faktet siç janë: procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit I dt.12.12.2023, kallëzimi penal me nr. të rastit 2022 AH 1044 I dt.16.11.2022,

raporti i policit hetues I dt.18.09.2022, raporti i oficerit i dt.09.11.2022, procesverbali I marrjes në pyetje për të dëmtuarin i dt.09.11.2022, vërtetimi për kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht I dt.18.09.2022, procesverbal I dëshmisë/pronës i dt.19.09.2022, raporti fillestar i incidentit i dt.18.09.2022, raporti i shpejtë i dt.17-18.09.2022, fotodokumentacioni, Cd-ja, raporti i oficerit i dt.18.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin E. P. i dt.08.11.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B. R. i dt.08.11.2022, raporti i oficerit i dt.19.09.2022, raporti i ekzaminimit të veturës i dt.18.09.2022, foto albumi i dt.19.09.2022, vërtetimi mbi kthimin e automjetit i dt.18.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin R. Z. i dt.18.09.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin I. Z. i dt.18.09.2022 si dhe shkresave të tjera të lëndës konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata e vlerësoi sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, moshën e tij të re dhe faktin se për here të pare ka rënë ndesh me ligjin, reflektimin në gabimet e bëra, I njejtë ka kërkuar falje ndaj të dëmtuarit, vetura I është kthyer të dëmtuarit, premtimin se nuk do ta përsërisë më asnjë veprë penale dhe sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale pra të njejtën nuk e ka përsëritur më, vet pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata pati për bazë intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është pasuria e të dëmtuarit, dhe të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së. Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 47 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoi se niveli kuantitativ dhe kualitativ i rrethanave lehtësuese e mbipeshon atë të rrethanave rënduese si dhe duke marrë parasyshë se i njejtë e pranoi fajësinë qysh në fillim atëherë Gjykata bëri zbutjen e dënimit nën minimumin e paraparë me ligj conform nenit 71 të KPRK-së i cili parasheh se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 të KPPRK-së, vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua conform nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.**  
**P.nr.581/23 me datën 24.02.2025**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

**GJYQTARI**

**Vesa Bajrami**

**Selman Salihi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.